FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 143

Tiranë – E hënë, 31 tetor 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 70/2022, datë 20.10.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin shtesë për projektin e zhvillimit të integruar urban dhe turizmin.....	17541
Dekret i Presidentit nr. 13867, datë 27.10.2022	Për shpallje ligji.....	17549
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 684, datë 26.10.2022	Për miratimin e marrëveshjes mbi bashkëpunimin për mbrojtjen ndaj katastrofave në Ballkanin Perëndimor.....	17549
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 21, datë 26.10.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 3743, datë 10.7.2017, "Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve", të ndryshuar.....	17556

LIGJ
Nr. 70/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR FINANCIMIN SHTESË PËR PROJEKTIN E ZHVILLIMIT TË INTEGRUAR URBAN DHE TURIZMIN

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin shtesë për projektin e zhvillimit të integruar urban dhe turizmin sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datën 20.10.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13867, datë 27.10.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

HUAJA NUMËR 9326-AL
MARRËVESHJE HUAJE
(**Financim shtesë për Projektin për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmit në Shqipëri**)
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

MARRËVESHJE, e cila mban datën e nënshkrimit ndërmjet REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ("Huamarrësi") dhe BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM ("Banka"). Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni I
Kushtet e përgjithshme; përkufizime

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohen në aneksin e kësaj Marrëveshjeje) zbatohen dhe janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përveç kur konteksti kërkon ndryshe, termat me germa të mëdha të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u janë caktuar atyre në kushtet e përgjithshme ose në aneksin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II
Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit shumën prej 30,000,000 euro (tridhjetë milionë euro), sipas konvertimit të saj herë pas here përmes konvertimit të monedhës ("Huaja"), për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje ("Projekti").

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas në përputhje me seksionin III të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa e parapagimit është e barabartë me një të katërtën e një përqindëshit (0.25%) të shumës së Huas.

2.04 Tarifa e angazhimit është e barabartë me një të katërtën e një përqindëshit (0.25%) në vit të shumës së patërhequr të Huas.

2.05 Norma e interesit është norma e referencës plus marzhin fiks ose norma e tillë që mund të

zbatohet pas një konvertimi; në bazë të seksionit 3.02/e të kushteve të përgjithshme.

2.06 Datat e pagesave janë data 1 prill dhe 1 tetor i çdo viti.

2.07 Shuma e principalit të Huas shlyhet në përputhje me skedulin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni III
Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi merr masa që Projekti të realizohet nga Enti Zbatues i Projektit në përputhje me dispozitat e nenit V të kushteve të përgjithshme, skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Projektit.

Neni IV
Mjetet ligjore të bankës

4.01 Rasti shtesë i pezullimit përbëhet nga sa vijon: specifikisht, ndryshimi, pezullimi, abrogimi, shfuqizimi ose heqja dorë nga legjislacioni i Entit Zbatues të Projektit, në një mënyrë që dëmton materialisht dhe negativisht aftësinë e Entit Zbatues të Projektit për të zbatuar çfarëdo detyrimi të tij në bazë të Marrëveshjes së Projektit ose Marrëveshjes Ndihmëse.

4.02 Rasti shtesë i përshpejtimit përbëhet nga sa vijon: specifikisht kur çdo rast i specifikuar në seksionin 4.01 të kësaj Marrëveshjeje ndodh dhe vazhdon të ndodhë për një periudhë prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, pasi Banka i jep Huamarrësit njoftim për rastin.

Neni V
Hyrja në fuqi; përfundimi

5.01 Afati kohor i hyrjes në fuqi është data 90 ditë (nëntëdhjetë) pas datës së nënshkrimit. Në bazë të seksionit 9.03 të kushteve të përgjithshme, me përjashtim si Banka dhe Huamarrësi do të bien dakord, kjo Marrëveshje do të hyjë në efekt në datën në të cilën Banka i dërgon Huamarrësit njoftim duke konfirmuar se është e kënaqur që kushtet e specifikuara në seksionin 9.01 janë plotësuar ("Data efektive").

Neni VI
Përfaqësimi; adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i Financave dhe Ekonomisë.

6.02 Për qëllime të seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme:

a) adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri; dhe

b) adresa elektronike e Huamarrësit është:

e-mail:
sekretariamin@financa.gov.al

6.03 Për qëllime të seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme:

a) adresa e Bankës është:

International Bank for Reconstruction and Development
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America; dhe

b) Adresa elektronike e Bankës është:

teleks:	faks:	e-mail:
248423(MCI) or 64145(MCI)	1-202-477-6391	esalinas@worldbank.org

PALËT RANË DAKORD në datën e nënshkrimit.
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Nga:

_____

Përfaqësues i autorizuar
Emri: DELINA IBRAHIMAJ
Titulli: MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Datë: 29.7.2022

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
NGA:

_____

Përfaqësues i autorizuar
Emri: EMANUEL SALINAS MUNOZ
Titulli: Menaxheri i Shqipërisë për IBRD
Datë: 8.2.2022

SKEDULI 1
Përshkrimi i Projektit

Objektivat e Projektit janë: (a) përmirësimi i infrastrukturës urbane; (b) përmirësimi i aseteve të turizmit; dhe (c) forcimi i kapaciteteve institucionale për të mbështetur zhvillimin ekonomik vendës të lidhur me turizmin në zonat e përzgjedhura në jug të Shqipërisë.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Zhvillimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës

Përmirësimi i infrastrukturës në zonat e përzgjedhura nëpërmjet: (a) përgatitjes së studimeve të fizibilitetit dhe projektimeve (duke përfshirë studimet e projektimeve urbane); (b) kryerjes së punimeve të ndërtimit për të restauruar ndërtesat e përzgjedhura të trashëgimisë; (c) zhvillimin e hapësirave publike, rrjetit rrugor dhe infrastrukturës përkatëse; dhe (d) kryerjen e mbikëqyrjes së ndërtimit.

Pjesa 2: Përmirësimi i zonave turistike

Përmirësimi i zonave të përzgjedhura turistike përgjatë jugut të korridorit turistik të Shqipërisë duke përfshirë, ndër të tjera: (a) restaurimin e aseteve të përzgjedhura të trashëgimisë së turizmit të orientuar ndaj trashëgimisë dhe turizmit kulturor, dhe duke krijuar zona pushimi ose pika turistike; (b) riparimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së zonave turistike, të tilla si trotuaret e këmbësorëve; (c) përgatitjen e studimeve të nevojshme të fizibilitetit, planeve të menaxhimit të vendeve turistike dhe projektimeve inxhinierike; dhe (d) kryerjen e mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit.

Pjesa 3: Zhvillimi i tregut të turizmit dhe produkteve të turizmit

Fuqizimi i kapaciteteve të bashkive për të ofruar shërbime bashkiake dhe mbështetja e tregut të turizmit dhe zhvillimit të produkteve, ndër të tjera, nëpërmjet: (i) ofrimit të pajisjeve për grumbullimin e mbetjeve të ngurta; (ii) krijimit të kapaciteteve për menaxhimin e zonës turistike për të përmirësuar funksionimin e aseteve të rehabilituara; (iii) zhvillimit dhe zbatimit të strategjive të hulumtimit të tregut dhe zhvillimit të produktit; (iv) krijimin e partneriteteve institucionale për të drejtuar aktivitetet e menaxhimit të destinacionit në nivel bashkiak dhe rajonal, duke përfshirë përgjigjen ndaj emergjencave shëndetësore, të tilla si COVID-19; (v) projektimin dhe zbatimin e statistikave të përmirësuara të turizmit kombëtar në Shqipëri.

Pjesa 4: Mbështetja gjatë zbatimit

Ofrimi i mbështetjes për të realizuar zbatimin e Projektit, duke përfshirë mirëmbajtjen e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të Projektit, si dhe trajnimin dhe financimin e kostove operative rritëse.

SKEDULI 2
Ekzekutimi i Projektit

Seksioni I. Masat e zbatimit

A. Masat institucionale

1. **Njësia për Koordinimin e Projektit dhe MIE-ja**

a) Huamarrësi, nëpërmjet MIE-së, angazhohet të:

i. mbajë, gjatë gjithë zbatimit të Projektit, NJKP-në me stafin kryesor të përbërë nga një planifikues urban, një specialist turizmi dhe një arkitekt, të gjithë me kualifikime, përvojë dhe terma reference të pranueshëm për Bankën; dhe

ii. garantojë që NJKP-ja të kryejë mbikëqyrjen dhe koordinimin e kontributeve teknike të bashkive të përzgjedhura për Projektin;

iii. koordinojë me PSC-në mbi përgjegjësitë e PSC-së në lidhje me zgjidhjen e ngërçeve që lindin gjatë zbatimit të Projektit, si dhe mbi lehtësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet agjencive kryesore qeveritare të përfshira në zbatimin e Projektit me bashkitë e përzgjedhura;

b) Huadhënësi, nëpërmjet MIE-së, mundëson që Enti Zbatues i Projektit, të:

i. mbajë, gjatë gjithë zbatimit të Projektit, personelin e tij kryesor të përbërë prej një menaxheri të Projektit, një arkitekti, një inxhinieri, një specialisti të menaxhimit financiar, një specialisti prokurimi, një specialisti turizmi, një specialisti për përfshirjen e qytetarëve, një specialisti mjedisi dhe një specialisti social, të gjithë me kualifikime, përvojë, përgjegjësi dhe burime të pranueshme nga Banka; dhe

ii. realizojë zbatimin e Projektit duke përfshirë menaxhimin financiar, prokurimin dhe menaxhimin e kontratës.

2. **Komiteti Drejtues i Projektit**

Huamarrësi:

a) mban gjatë zbatimit të Projektit, një Komitet Drejtues të Projektit ("KDP"), të përbërë nga përfaqësues nga MIE-ja, MTM-ja, MK-ja, MFE-ja, Departamenti për Programimin e Zhvillimit,

Financimit dhe Ndihmës së Huaj, Enti Zbatues i Projektit dhe bashkitë e përzgjedhura, dhe përfaqësues të tjerë të përcaktuar në Manualin Operacional; dhe

b) garanton që KDP-ja: (i) të mblidhet të paktën çdo 6 (gjashtë) muaj; (ii) mbështet MIE-në për mbikëqyrjen e përgjithshme të projektit të lidhur me menaxhimin e Projektit, duke përfshirë, ndër të tjera, mbështetjen e koordinimit të palëve të interesuara dhe zgjidhjen e çështjeve kryesore ndërsektoriale ose të pengesave që dalin gjatë zbatimit të Projektit.

B. Masat e zbatimit

1. **Manuali Operacional i Projektit**

a) Jo më vonë se 90 ditë pas datës efektive, Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, garanton që Enti Zbatues i Projektit të përditësojë, miratojë, më pas të mbajë dhe të realizojë Projektin në përputhje me parashikimin e një manuali (Manuali Operacional i Projektit) në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, i cili përfshin: (i) një përshkrim të hollësishëm të Projektit; (ii) listën e vendeve turistike të përzgjedhura, zonat dhe bashkitë e përzgjedhura; (iii) procedurat për zbatimin e Projektit; (iv) masa të hollësishme institucionale, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe duke përfshirë, *ndër të tjera*, afatet kohore të veprimtarive që duhet të kryhen në bazë të Projektit, personelin, aspektet e besimit, teknike dhe operacionale dhe procedurat për zbatimin e Projektit; (v) procedurat e menaxhimit financiar (buxhetin, kontabilitetin dhe kontrollin e brendshëm, disbursimin dhe qarkullimin e fondeve, raportimin financiar, raportet vjetore, procedurat e masave të kontrollit të brendshme dhe të jashtëm, duke përfshirë edhe skemën specifike të kontabilitetit të Projektit); (vi) modelin e marrëveshjes së bashkëpunimit; (vii) procedurat e prokurimit; (viii) KMMS-në dhe RPF-në; (ix) masat për monitorimin dhe vlerësimin e Projektit; (x) treguesit e monitorimit të Projektit; (xi) masa të tjera të besimit dhe administrative, sipas ndryshimeve herë pas here të manualit në fjalë, në marrëveshje me Bankën; dhe (xii) Manualin PEK.

b) Me përjashtim të rastit kur Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, dhe Banka mund të bien dakord ndryshe me shkrim, Huamarrësi nuk lejon që Enti Zbatues i Projektit të shfuqizojë, ndryshojë, pezullojë, heqë dorë ose të mos zbatojë në një formë tjetër Manualin Operacional të Projektit ose ndonjë dispozitë të tij;

c) Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis dispozitave të Manualit Operacional të Projektit dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

2. Marrëveshja Ndihmëse

a) Për të lehtësuar realizimin e Projektit, Huamarrësi i vë në dispozicion nëpërmjet grantit, të ardhurat e Huas Entit Zbatues të Projektit sipas Marrëveshjes Ndihmëse ("Marrëveshja e Kanalizimit") të lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Entit Zbatues të Projektit, sipas termave dhe kushteve të miratuara nga Banka.

b) Huamarrësi ushtron të drejtat e tij dhe kryen detyrimet e parashikuara në Marrëveshjen Ndihmëse, në mënyrë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe Bankës dhe të përmbushë qëllimet e Huas. Me përjashtim të rastit kur Banka bie dakord ndryshe, Huamarrësi nuk mund të transferojë, ndryshojë, shfuqizojë ose heqë dorë nga Marrëveshja Ndihmëse ose nga ndonjë prej dispozitave të saj.

C. Masat mbrojtëse

1. Për të garantuar zbatimin e duhur të Projektit, në mënyrë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore dhe sociale, Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, garanton që Enti Zbatues i Projektit, të:

a) zbatojë Projektin në përputhje me Instrumentet e Masave Mbrojtëse për Projektin;

b) para realizimit të çdo pune në kuadër të Projektit: (i) të përgatisë PMMS-në për zonën e caktuar turistike në përputhje me KMMS-në përkatëse, duke përfshirë bërjen publike dhe konsultimin publik, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën; dhe (ii) të zbatojë veprimtaritë e Projektit në përputhje me PMMS-të përkatëse;

c) para kryerjes së çdo punimi në kuadër të Projektit, i cili përfshin risistemimin e pavullnetshëm, të përgatisë një PLS për zonën e caktuar turistike në përputhje me KPR-në, duke përfshirë bërjen publike dhe konsultimin serioz me personat e prekur nga Projekti, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, dhe të garantojë zbatimin e një PLS-je të tillë, duke përfshirë sigurimin e kompensimit të duhur në përputhje me dispozitat e KPR-së dhe PLS-së për zonat e caktuara turistike, për personat e prekur nga Projekti; dhe

d) të mostransferojë, ndryshojë, shfuqizojë ose heqë dorë nga Instrumentet e Masave Mbrojtëse ose ndonjë dispozitë e tyre, pa miratimin paraprak të Bankës.

2. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis dispozitave të Instrumentit të Masave Mbrojtëse dhe parashikimeve të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

3. Huamarrësi, nëpërmjet MIE-së, garanton që Enti Zbatues i Projektit të sigurojë që termat e referencës për çfarëdolloj konsulence të lidhur me Projektin të jenë të pranueshme për Bankën pas shqyrtimit të tyre nga ana e saj dhe, për këtë qëllim, në këta terma reference përfshihen sipas rregullave kërkesat e politikave të Bankës në lidhje me masat mbrojtëse në fuqi në atë kohë, siç zbatohet për këshillat që jepen nëpërmjet një asistence teknike.

D. Plani vjetor i punës dhe buxheti

1. Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, garanton që EZP-ja të përgatisë dhe t'i dorëzojë Bankës për shqyrtim dhe miratim, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas ditës së hyrjes në fuqi dhe në vijim deri më 31 tetor të çdo viti fiskal gjatë zbatimit të projektit, një plan vjetor të punës dhe buxhetin vjetor të propozuar që mbulojnë të gjitha veprimtaritë e propozuara për t'u kryer në kuadër të Projektit gjatë vitit të ardhshëm fiskal.

2. Në çdo plan të tillë vjetor pune dhe buxhet vjetor të propozuar, ndër veprimtaritë, përcaktohet qartë çdo aktivitet trajnimi që mund të kërkohet në bazë të Projektit, duke përfshirë: (a) llojin e trajnimit; (b) qëllimin e trajnimit; (c) personelin që do të trajnohet; (d) institucionin ose individin që do të zhvillojë trajnimin; (e) vendin dhe kohëzgjatjen e trajnimit; (f) koston e trajnimit; dhe (g) rezultatin dhe ndikimin e pritshëm të trajnimit.

3. Huamarrësi, nëpërmjet MIE-së, i ofron Bankës mundësi të arsyeshme për të shkëmbyer pikëpamje me Huamarrësin, lidhur me çdo plan vjetor pune dhe buxhet vjetor të propozuar, dhe në vijim zbaton Projektin ose garanton zbatimin e projektit nga NJZP-ja me kujdesin e duhur, në përputhje me planin vjetor të punës dhe buxhetin vjetor, siç miratohet nga Banka.

Seksioni II. <u>Monitorimi dhe vlerësimi i Projektit dhe raportimi në lidhje me të</u>

Huadhënësi i dorëzon çdo raport projekti Bankës jo më vonë se një muaj pas përfundimit të çdo gjashtëmujori kalendarik, raport i cili mbulon gjashtëmujorin kalendarik.

Seksioni III. <u>Tërheqja e të ardhurave të Huas</u>

A. Të përgjithshme

Pa u kufizuar në dispozitat e nenit II të kushteve të përgjithshme dhe në përputhje me letrën e disbursimit dhe informacionit financiar, Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas, për të: (a) financuar shpenzimet e pranueshme; dhe (b) për të paguar: (i) tarifën paraprake; dhe (ii) secilin tavan të normës së interesit ose primit të kufirit të normës së interesit; në shumën e alokuar dhe, nëse është e zbatueshme, deri në përqindjen e përcaktuar në raport sipas kategorive të tabelës më poshtë:

Kategoria	Shuma e dhënë e Huas (e shprehur në EURO)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
1. Mallra, punime, shërbime jokonsulence, shërbime konsulence nënpjesët 1, 3 dhe 4 të Projektit	26,225,000	100%
2. Shpenzimet e konsulencës dhe trajnimet nënpjesët 1, 3 dhe 4 të Projektit	2,500,000	100%
3. Kostot operative	1,200,000	100%
4. Tarifa e parapagimit	75,000	Shuma për t'u paguar në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07 (b) të kushteve të përgjithshme
5. Tavani i normës së interesit ose primi i kufirit të normës së interesit	0	Shuma për t'u paguar në përputhje me seksionin 4.05 (c) të kushteve të përgjithshme
SHUMA TOTALE	30,000,000	

B. Kushtet e tërheqjes; periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A më sipër, nuk bëhet asnjë tërheqje për pagesat e kryera para datës së nënshkrimit.

2. Data e mbylljes është data 31 korrik 2025.

Seksioni V. Sipërmarrje të tjera/studime të tjera projektimi urban

1. Huamarrësi, nëpërmjet MIE-së, garanton që Enti Zbatues i Projektit siguron që çdo studim i projektimit urban i ndërmarrë sipas pjesës 1/a të Projektit, të jetë i pranueshëm për Bankën.

2. Huamarrësi nuk do të kërkojë tërheqje për shpenzimet e pranueshme sipas kësaj Marrëveshjeje: (i) që janë tashmë financuar me të ardhurat nga Marrëveshja Fillestare e Huas; ose (ii) për të cilat ka kërkuar tërheqje sipas Marrëveshjes Fillestare të Huas.

SKEDULI 3

Afati i shlyerjes së amortizimit të lidhur me angazhimin

Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të Huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të Huas, të pagueshme në çdo datë të pagimit të principalit ("Përqindja e kështit")

Niveli i shlyerjeve të principalit

Data e pagesës së principalit	Përqindja e kështit
Çdo datë 1 prill dhe 1 tetor - Fillon më 1 prill 2026 - deri më 1 tetor 2037 1 tetor 2037	4.17% 4.09%

ANEKS

Seksioni I. Përkufizime

1. "Udhëzime antikorrupsion" nënkupton, për qëllime të paragrafit 5 të shtojcës së kushteve të përgjithshme, "Udhëzimet për parandalimin dhe luftimin e mashtrimit dhe korrupsionit për projektet e financuara me huat e BNRZH-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-s", datë 15 tetor 2006 dhe rishikuar në janar 2011 dhe më 1 korrik 2016.

2. "Politikat e Bankës për masat mbrojtëse" nënkupton politikat dhe procedurat operacionale të Bankës, të përcaktuara në Manualin Operacional të Bankës dhe të identifikuara si OP/BP 4.01, 4.04, 4.09, 4.10, 4.11, 4.12, 4.36, 4.37, 7.50 dhe 7.60, manual i cili është botuar në adresën: www.WorldBank.org/opmanual.

3. "Kategori" nënkupton çdo kategori të përcaktuar në tabelën në seksionin III.A të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

4. "Marrëveshje Bashkëpunimi" nënkupton një marrëveshje ndërmjet Entit Zbatues të Projektit dhe një bashkie, ministrie ose agjencie qeveritare të përzgjedhur dhe të përmendur në seksionin 1.B.2 të skedulit të Marrëveshjes së Projektit.

5. "COVID-19" nënkupton sëmundjen e koronavirusit të shkaktuar nga koronavirusi i ri i vitit 2019 (SARS-CoV-2).

6. "Departament i Programimit të Zhvillimit, Financimit dhe Ndihmës së Huaj" nënkupton njësinë në Zyrën e Kryeministrit, të krijuar dhe që funksionon në përputhje me urdhrin e Kryeministrit nr. 204, datë 1 nëntor 2013 ose pasuesit e tij.

7. "Partneritetet e Menaxhimit të Destinacioneve" nënkupton koalicionin e grupeve të interesit të turizmit brenda zonave të caktuara, të cilët takohen rregullisht, mbikëqyrin dhe bashkërendojnë aktivitete të lidhura me turizmin.

8. "Kuadri për menaxhimin mjedisor dhe social" ose "KMMS" nënkupton kuadrin e Projektit, të përgatitur nga Enti Zbatues i Projektit dhe të botuar në *InfoShop*-in e Bankës, më 21 qershor 2016 dhe në faqen e internetit të Entit Zbatues të Projektit në datën 22 qershor 2016, i cili përcakton, *ndër të tjera*, modalitetet për shqyrtimin mjedisor dhe social specifik të zonës së caktuar turistike, duke përfshirë: (a) udhëzimet për identifikimin e kushteve ekzistuese mjedisore dhe sociale dhe ndikimet e mundshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta mjedisore dhe sociale dhe rreziqet që rrjedhin nga realizimi i projekti; (b) udhëzimet për kryerjen e vlerësimeve mjedisore dhe sociale dhe përgatitjen e planeve të menaxhimit mjedisor, kur është e zbatueshme; (c) rekomandimin e masave zbutëse për secilin ndikim negativ të identifikuar; (d) masat për rritjen e çdo ndikimi pozitiv të identifikuar; dhe (e) udhëzimet për përgatitjen e planeve të monitorimit mjedisor dhe social për ndjekjen e zbatimit të masave zbutëse, sipas ndryshimeve të kuadrit të përmendur, të ndryshuar herë pas here me miratimin paraprak të Bankës.

9. "Plan/et i/e menaxhimit mjedisor dhe social" ose "PMMS" nënkupton planet specifike të menaxhimit mjedisor dhe social, të pranueshme për Bankën, duke përfshirë planin e zbutjes së

ndikimeve mjedisore dhe planin e monitorimit të mjedisit, të cilat do të përgatiten dhe miratohen nga Enti Zbatues i Projektit në përputhje me KMMS-në, ku përcaktohen detajet specifike të masave për të menaxhuar rreziqet e identifikuara ose të mundshme mjedisore dhe sociale dhe për të zbutur, zvogëluar dhe/ose kompensuar ndikimet e pafavorshme mjedisore dhe sociale të lidhura me zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Projekt, së bashku me një bazë mjedisore dhe sociale fillestare për çdo zone turistike, detajet e kuadrit përkatës legjislativ mjedisor, masat e duhura institucionale, monitoruese dhe raportuese të afta për të garantuar zbatimin e duhur dhe komentet e rregullta mbi pajtueshmërinë me kushtet e saj, plane që mund të ndryshohen dhe të plotësohen herë pas here me miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

10. "PMMS për Rrugën e Kalldrëmtë të Beratit" dhe "Shkallët e Sarandës" nënkupton secilin nga planet e menaxhimit mjedisor dhe social të përgatitur dhe miratuar nga Huamarrësi dhe EZP-ja përkatësisht për zonat turistike të Beratit dhe Sarandës, të pranueshme nga Banka dhe të botuara në *InfoShop* në datën 18 korrik 2016.

11. "Kushtet e përgjithshme" nënkupton kushtet e përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin IBRD, Financimin e Projektit të Investimit, datë 14 dhjetor 2018 (rishikuar më 1 gusht 2020, 21 dhjetor 2020, 1 prill 2021 dhe 1 janar 2022).

12. "Risistemi i pavullnetshëm" nënkupton ndikimin nga marrja e tokës në mënyrë të pavullnetshme në bazë të Projektit, i cili shkakton që personave të prekur nga Projekti, ndër të tjera: (a) t'u cenohet negativisht niveli i jetesës; apo (b) t'u cenohet e drejta, titulli apo interesi mbi një shtëpi, tokë (duke përfshirë ndërtesat, tokën bujqësore dhe kullotën) apo ndonjë pasuri tjetër të tundshme apo të patundshme, të trashëguar ose në zotërim, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme; apo (c) t'u cenohet negativisht, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme, mundësia për përdorimin e aseteve produktive; apo (d) t'u cenohen negativisht, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme, veprimtaria tregtare, puna dhe vendi i punës, i qëndrimit apo i banimit.

13. "MK" nënkupton Ministrinë e Kulturës të Huamarrësit apo pasuesit e tij.

14. "MTM" nënkupton Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit e të Huamarrësit apo pasuesit e tij

15. "MFE" nënkupton Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Huamarrësit apo pasuesit e tij.

16. "MIE" nënkupton Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë apo pasuesit e tij.

17. "Kosto operative" nënkupton shpenzimet shtesë të kryera nga Enti Zbatues i Projektit dhe NJKP-ja për llogari të zbatimit të Projektit, ku nuk mungojnë menaxhimi dhe monitorimi i Projektit, dhe ku përfshihen shpenzimet për qiranë e zyrës, funksionimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, pajisjet dhe materialet e zyrës, shpenzimet për komunikimin, mbështetjen për sistemin e informacionit, përkthimet, tarifat bankare, shpenzimet për udhëtim dhe dieta, pagat e stafit të kontraktuar të Entit Zbatues të Projektit (duke përjashtuar shërbimet e konsulencës dhe pagat e punonjësve të shërbimit civil të përfituesit), kontributet shoqërore për stafin e Entit Zbatues të Projektit, shpenzimet administrative për zyrën dhe shpenzime të tjera të arsyeshme që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e Projektit, siç bie dakord Banka; dhe mbi bazën e një buxheti vjetor të pranueshëm për Bankën.

18. "Marrëveshje Fillestare e Huas" nënkupton marrëveshjen ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës për Projektin, datë 13 dhjetor 2016, të ndryshuar. "Marrëveshja Fillestare e Huas" përfshin të gjitha shtojcat, skedulet dhe marrëveshjet shtesë të Marrëveshjes Fillestare të Huas.

19. "Agjencitë pjesëmarrëse të qeverisjes qendrore" nënkupton MK-në, MTM-në, MFE-në dhe MIE-në.

20. "Rregullore e prokurimit" nënkupton ë, për qëllime të paragrafit 85 të shtojcës së kushteve të përgjithshme, "Rregulloret e prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e IPF-së", të korrikut të vitit 2016, të rishikuar në nëntor 2017 dhe gusht 2018 dhe nëntor 2020.

21. "Personat e prekur nga Projekti" nënkupton persona, të cilët, për shkak të zbatimit të Projektit, janë prekur ose do të preken nga risistemimi i pavullnetshëm.

22. "Marrëveshje për Projektin" nënkupton marrëveshjen që duhet të lidhë Banka dhe Enti Zbatues i Projektit, dhe që përmendet në seksionin 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshje që mund

të ndryshohet herë pas here, dhe ky kusht vlen për të gjitha shtojcat dhe marrëveshjet shtesë të Marrëveshjes për Projektin.

23. "Njësia për Koordinimin e Projektit" apo NJKP-ja nënkupton njësinë që ngrihet në MIE dhe përmendet në seksionin I.A.1 të Skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

24. "Enti Zbatues i Projektit" ose "EZP" nënkupton Fondin Shqiptar të Zhvillimit ose FSHZH-në, fondacion jofitimprurës me pavarësi administrative, financiare dhe teknike.

25. "Legjislacioni i Entit Zbatues të Projektit" nënkupton ligjin nr. 10130, datë 11.5.2009 dhe ligjin e Huamarrësit nr. 82, datë 17.7.2009.

26. "Manuali Operacional i Projektit" nënkupton manualin e përmendur në seksionin I.B.1(a) të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

27. "Plani i prokurimeve" nënkupton planin e Huamarrësit për prokurimet për Projektin, të datës 15 korrik 2016 dhe që përmendet në paragrafin 1.18 të udhëzuesit për prokurimin dhe në paragrafin 1.25 të udhëzuesit për konsulentët, sipas përditësimeve të tij herë pas here në përputhje me dispozitat e paragrafëve në fjalë.

28. "Plani i Veprimit për Risistemimin" ose "PVR" nënkupton ë një plan të pranueshëm për Bankën, i cili duhet të përgatitet dhe zbatohet nga Enti Zbatues i Projektit për kryerjen e veprimtarive në kuadër të Projektit në përputhje me Kuadrin e Politikave për Risistemimin, dhe që parashikon, ndër të tjera, parimet dhe objektivat, kriteret e pranueshmërisë për personat e prekur, të drejtat për kompensim, asistencë dhe rehabilitim, si dhe procedurat e monitorimit dhe raportimit në përputhje me Kuadrin e Politikave për Risistemimin, plan që mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak të Bankës.

29. "Kuadri i Politikave për Risistemimin" ose "KPR" nënkupton dokumentin e përgatitur nga Enti Zbatues i Projektit dhe të botuar në faqen e internetit të Entit Zbatues të Projektit në datën 21 qershor 2016 dhe në *Infoshop*-in e Bankës në datën 22 qershor 2016, i pranueshëm për Bankën, ku përcaktohen modalitetet për blerjen e tokës në kuadër të Projektit dhe jepet një përshkrim i politikave, procedurave, planeve dhe veprimeve (duke përfshirë përgatitjen e planeve të veprimit për risistemimin) dhe i masave institucionale në lidhje me blerjen e tokës dhe i ndikimeve të tjera sociale që mund të ndodhin gjatë Projektit, kuadër që mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak të Bankës.

30. "Instrument i Masave Mbrojtëse" nënkupton KMMS-në, PMMS-në, KPR-në ose një PLS për një veprimtari të Projektit, siç mund ta kërkojë konteksti; dhe "Instrumente të masave mbrojtëse", bashkërisht, i referohen të gjitha këtyre vlerësimeve ose planeve për Projektin.

31. "Zonat e përzgjedhura" nënkupton bashkitë e përzgjedhura dhe korridorin turistik dhe çdo zonë tjetër brenda territorit të Huamarrësit, siç përcaktohet në Manualin Operacional të Projektit.

32. "Bashkitë e Përzgjedhura" nënkupton bashkitë e Huamarrësit, të përcaktuara në Manualin Operacional të Projektit.

33. "Data e nënshkrimit" nënkupton datën më të vonë nga të dy datat kur Huamarrësi dhe Banka e nënshkruajnë këtë Marrëveshje dhe ky përkufizim zbatohet për të gjitha referencat ndaj "datës së Marrëveshjes së Huas" në kushtet e përgjithshme.

34. "Kontribute shoqërore" nënkupton çdo pagesë, prim apo kontribut për sigurimin shëndetësor dhe shoqëror që u sigurohet punonjësve të Entit Zbatues të Projektit në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11 maj 1993, të Huamarrësit, të ndryshuar.

35. "Marrëveshje ndihmëse" nënkupton marrëveshjen që përmendet në seksionin I.B.2 të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje, në zbatim të së cilës Huamarrësi i vë të ardhurat e Huas në dispozicion të Entit Zbatues të Projektit.

36. "Drejtoria e Turizmit dhe Kulturës" nënkupton një drejtori në një Bashki të Përzgjedhur përgjegjëse për turizmin dhe kulturën.

37. "Korridor turistik" nënkupton rrugën e transportit që lidh qytetin e Vlorës me Bashkitë e Përzgjedhura, siç përshkruhet më tej në Manualin Operacional.

38. "Trajnim" nënkupton shpenzimet (përveç atyre për shërbimet e konsulencës) që kryen Enti Zbatues i Projektit në lidhje me zbatimin e Projektit, mbi bazën e buxheteve periodike të pranueshme për Bankën, për: (i) shpenzime të arsyeshme për udhëtim, fjetje, ushqim dhe dieta që kryejnë trajnuesit dhe të trajnuarit në lidhje me trajnimin e tyre; (ii) tarifat e kurseve; (iii) marrjen me qira të mjediseve dhe pajisjeve për

trajnim/seminare me veprimtari praktike; dhe (iv) shpenzimet për përgatitjen, blerjen, riprodhimin dhe shpërndarjen e materialeve të trajnimit që nuk janë të përfshira në marrëveshjet për mallrat apo të sipërmarrësve të shërbimeve.

DEKRET
Nr. 13867, datë 27.10.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 70/2022, "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për projektin e zhvillimit të integruar urban dhe turizmin".

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 684, datë 26.10.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES MBI BASHKËPUNIMIN PËR MBROJTJEN NDAJ KATASTROFAVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes mbi bashkëpunimin për mbrojtjen ndaj katastrofave në Ballkanin Perëndimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
MBI BASHKËPUNIMIN PËR MBROJTJEN NDAJ KATASTROFAVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Ne, Pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor të referuar bashkërisht si "Palë Kontraktuese" dhe individualisht si "Pala Kontraktuese",

të bindur për domosdoshmërinë e bashkëpunimit të ndërsjellë në parandalimin dhe zbutjen e pasojave të katastrofave;

në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara ndërkombëtare;

në pranim të përpjekjeve të Kombeve të Bashkuara në fushën e parandalimit të katastrofave dhe zbutjen e pasojave;

duke pasur parasysh Mekanizmin e Bashkimit për Mbrojtjen Civile dhe kontributin e tij në zhvillimin e kapaciteteve për veprim të shpejtë dhe efektiv, dhe organizata të tjera ndërkombëtare, në lidhje me mbrojtjen nga pasojat e katastrofave;

duke ripohuar synimin, interesin dhe bazën e ndërsjellë për përmirësimin e bashkëpunimit dhe të partneritetit,

kanë rënë dakord si vijon.

Neni 1
Objekti i Marrëveshjes

Në këtë Marrëveshje, Palët Kontraktuese rregullojnë kuadrin e kushteve për sigurimin vullnetar të ndihmës, në rast katastrofash, dhe, veçanërisht, në:

- planifikimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse ndaj përmbytjeve, tërmeteve, zjarreve, ndotjes së mjedisit, aksidenteve të mjeteve lundruese, rreziqeve radiologjike, pandemive të ndryshme, si dhe katastrofave industriale dhe të tjera;
- njoftimin e ndërsjellë ndaj kërcënimeve, dukurive dhe pasojave të katastrofave;
- ndihmën e ndërsjellë në shpëtimin, sigurimin e ndihmës dhe eliminimin e pasojave të katastrofave, me anë të forcave tokësore dhe ajrore dhe automjetet për ndërhyrje, në raste zjarresh masive, përmbytjesh, tërmetesh dhe katastrofash të tjera;
- edukimin dhe trajnimin e personelit të shërbimeve, njësive të mbrojtjes dhe të shpëtimit, njësive të mbrojtjes nga zjarri dhe anëtarëve të tjerë të ekipeve të shpëtimit, nëpërmjet informimeve, kurseve, trajnimeve, seminareve dhe formave të tjera të bashkëpunimit, si dhe organizimin dhe

kryerjen e stërvitjeve të përbashkëta të shpëtimit dhe ndihmës etj.;

- shkëmbimin e të dhënave shkencore dhe teknike, si dhe dokumenteve të tjera, që lidhen me mbrojtjen nga katastrofat;

- bashkëpunimin në zhvillimin dhe prodhimin e pajisjeve të shpëtimit dhe ndihmës.

Neni 2
Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që Palët Kontraktuese, në përputhje me kapacitetet e tyre përkatëse në dispozicion, të ndihmojnë njëra-tjetrën në rast katastrofash, kur Pala Kontraktuese Kërkuese nuk është në gjendje të përballojë pasojat e katastrofës duke përdorur burimet e saj.

Neni 3
Përkufizimet

Termat e përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimin si më poshtë:

1. "Palë Kontraktuese Kërkuese" nënkupton Palën Kontraktuese, autoriteti kompetent i së cilës kërkon ndihmë.

2. "Pala Ndihmëse Kontraktuese" nënkupton Palën Kontraktuese, autoriteti kompetent i së cilës përgjigjet për kërkesat për ndihmë.

3. "Pala Kontraktuese Tranzit" nënkupton Palën Kontraktuese, përmes territorit të së cilës duhet të kalojnë njësitë dhe pajisjet e ndihmës për nevojat e njërës prej Palëve Kontraktuese ose për nevojat e një vendi të tretë.

4. "Katastrofë" nënkupton një ndërprerje serioze të funksionimit të një komuniteti ose një shoqërie në çdo shkallë, për shkak të ngjarjeve të rrezikshme që ndërveprojnë me kushtet e ekspozimit, cenueshmërisë dhe kapacitetit, duke çuar në një ose më shumë nga sa vijon: humbje dhe ndikime në njerëz, materiale, ekonomike dhe mjedisore.

5. "Njoftimet dhe informacioni në lidhje me një ngjarje" nënkupton të dhëna mbi katastrofat e transmetuara Palëve të tjera Kontraktuese, me qëllim paralajmërimin e rreziqeve, mundësinë e ngjarjes së katastrofave që mund të rrezikojnë Palë të tjera Kontraktuese.

6. "Masa mbrojtjeje" nënkupton aktivitetet e parandalimit dhe të mbrojtjes të ndërmarra, me qëllim parandalimin, zbutjen dhe eliminimin e rreziqeve që kërcënojnë popullatën dhe/ose ruajtjen e pasurive materiale dhe mjedisit.

7. "Shpëtim" nënkupton ndërmarrjen e masave konkrete, aktiviteteve dhe procedurave për mbrojtjen e njerëzve, jeta ose shëndeti i të cilëve është i rrezikuar; i kafshëve, bimësisë, pasurisë dhe trashëgimisë kulturore nga pasojat e katastrofave përmes ndërmarrjes së veprimeve konkrete, si përgjigje ndaj katastrofave natyrore dhe katastrofave të tjera nga ekspertë, skuadra ose njësi shpëtimi.

8. "Ekipet e shpëtimit dhe ekspertët individualë që marrin pjesë në sigurimin e ndihmës" nënkupton personat e trajnuar dhe të pajisur në mënyrë të duhur, të dërguar nga Pala Kontraktuese Ndihmëse me kërkesë për ndihmë.

9. "Mbrojtje, shpëtim dhe pajisje të tjera" nënkupton të gjitha mjetet e nevojshme për mbrojtjen dhe shpëtimin individual ose kolektiv, duke përfshirë mjetet teknike dhe mjete të tjera të mbrojtjes dhe të shpëtimit të përdorura nga ekipet e shpëtimit dhe ekspertë individualë në shpëtimin ose sigurimin e ndihmës, si dhe mjetet e mbështetjes logjistike.

10. "Ndihmë humanitare" nënkupton materiale në natyrë, artikuj, burime, furnizime, ujë të pijshëm, barna dhe furnizime mjekësore të synuara për popullatën e rrezikuar ose të prekur, në mënyrë që të zbuten efektet e pafavorshme të katastrofave.

Neni 4
Autoritetet kompetente

Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike të autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Palët Kontraktuese informojnë reciprokisht njëra-tjetrën, në lidhje me adresat dhe telekomunikacionet e autoriteteve kompetente, sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe për pikat e kontaktit që duhet të jenë të disponueshme në çdo moment.

Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën me shkrim për ndryshimet e mundshme të autoriteteve kompetente, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas ditës kur janë kryer ndryshimet.

Autoritetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni autorizohen që të krijojnë komunikim të drejtpërdrejtë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe për këtë qëllim, përpunojnë procedurat standarde të funksionimit për sigurimin e ndihmës në rast katastrofash.

Neni 5
Shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës

Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për zhvillimet dhe përvojat shkencore e teknike, me qëllim parashikimin, zbutjen dhe eliminimin e pasojave të katastrofave dhe mbrojtjen e shpëtimin efikas.

Shkëmbimi i njohurive, informacionit dhe dokumenteve të tjera përfshin informacion mbi katastrofat, informacionin e kërkuar për hartimin e një programi të përbashkët shkencor dhe kërkimor në rast rreziku, planet për kërcënim dhe katastrofë të përgjithshme dhe kërcënime me interes të përbashkët për Palët Kontraktuese, si dhe bashkëpunim në planifikim dhe në shpëtim.

Bashkëpunimi në fushën e shkëmbimit të njohurive dhe përvojës kryhet në përputhje me legjislacionin e Palëve Kontraktuese. Palët Kontraktuese shkëmbejnë informacion në përputhje me legjislacionin e tyre.

Palët Kontraktuese përpiqen të përdorin në mënyrë efikase rezultatet e bashkëpunimit shkencor dhe teknik dhe në bashkëpunim me vendet e tjera, në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6
Zhvillimi dhe prodhimi i pajisjeve mbrojtëse dhe shpëtuese

Palët Kontraktuese inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet subjekteve të biznesit dhe institucioneve në fushën e zhvillimit teknologjik, prodhimin e pajisjeve dhe zbatimin e programeve të përbashkëta të mbrojtjes dhe shpëtimit.

Neni 7
Bashkëpunimi ndërmjet organizatave humanitare

Palët Kontraktuese inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, subjekteve të biznesit dhe organizatave humanitare në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga katastrofat, në përputhje me legjislacionin e Palëve Kontraktuese.

Neni 8
Edukimi dhe zhvillimi profesional

Palët Kontraktuese inkurajojnë bashkëpunimin e ndërsjellë, me qëllim edukimin dhe zhvillimin profesional të ekipeve të shpëtimit, që marrin pjesë në mbrojtjen dhe shpëtimin me anë të:

1. Vendosjes së komunikimit dhe të bashkëpunimit të drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve arsimore dhe inkurajimit të shkëmbimit të instruktorëve, pedagogëve dhe ekspertëve të tjerë;
2. Bashkëpunimit në arsim dhe në trajnim;
3. Shkëmbimit të ndërsjellë të materialeve dhe burimeve mësimore, si dhe përvojave të fituara në mbrojtje dhe në shpëtim, thelbësore për arsimin dhe zhvillimin profesional;
4. Organizimit të stërvitjeve të përbashkëta në fushën e mbrojtjes civile dhe të shpëtimit;
5. Stërvitjet e përbashkëta kryhen në terren edhe me forca operacionale.

Neni 9
Detyrimi për të njoftuar në lidhje me kërcënimet

Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për kërcënimet dhe ndodhjen e mundshme të katastrofave, të cilat mund të rrezikojnë Palët e tjera Kontraktuese.

Për qëllim të njoftimit të njëra-tjetrës, secila Palë Kontraktuese mbledh të dhënat dhe informacionin e nevojshëm dhe do t'ua transmetojë drejtpërdrejt autoriteteve përgjegjëse të Palëve të tjera Kontraktuese.

Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për katastrofat që ndodhin në zonën e tyre.

Njoftimi përfshin: një përshkrim të kërcënimit ose të ngjarjes që ka ndodhur, informacion mbi vendin, kohën, shtrirjen dhe pasojat, si dhe masat e ndërmarra.

Njoftimi i përmendur në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni mund të transmetohet verbalisht ose me shkrim në gjuhët e Palëve Kontraktuese dhe/ose në gjuhën angleze. Njoftimet e komunikuara verbalisht, gjithashtu, duhet të konfirmohen me shkrim.

Autoritetet e përmendura në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje janë përgjegjëse për dërgimin dhe marrjen e njoftimeve për kërcënime, rreziqe dhe katastrofa të ndodhura.

Neni 10
Masat e mbrojtjes

Palët Kontraktuese planifikojnë dhe ndërmarrin masat e duhura të mbrojtjes së përbashkët, në mënyrë që të parandalojnë ose të zvogëlojnë një kërcënim të përbashkët.

Palët Kontraktuese ndërmarrin, gjithashtu, masa dhe aktivitete parandaluese për mbrojtjen dhe shpëtimin dhe përditësimin e institucioneve për zbutjen e rreziqeve dhe të pasojave të katastrofave natyrore dhe katastrofave të tjera.

Neni 11
Kërkimi dhe dhënia e ndihmës

Pala Kontraktuese e prekur nga një katastrofë mund të kërkojë ndihmë nga Palët e tjera Kontraktuese. Kjo ndihmë mund t'u drejtohet ekipeve të shpëtimit, ekspertëve individualë, pajisjeve të mbrojtjes dhe shpëtimit, si dhe ndihmës humanitare ndërkombëtare.

Kërkesa për ndihmë, e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të përfshijë: informacionin mbi katastrofën (data, ora dhe vendi i ndodhjes), llojin dhe shkallën e ndihmës së kërkuar, institucionet dhe personat me të cilët vendoset komunikimi, si dhe një propozim mbi mënyrën e dhënies së ndihmës.

Kërkesa e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni paraqitet në gjuhën angleze.

Pala Kontraktuese Ndihmëse njofton Palën Kontraktuese Kërkuese për burimet e saj të mundshme për t'u vendosur në dispozicion, si dhe për mundësitë dhe mënyrën e ofrimit të ndihmës. Autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese Ndihmëse i paraqet autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese Kërkuese listën e anëtarëve të ekipit të shpëtimit, ekspertë individualë dhe listën e inventarit të pajisjeve të mbrojtjes dhe të shpëtimit, dhe të ndihmës humanitare.

Ndihma sigurohet në përputhje me legjislacionin e Palëve Kontraktuese.

Autoritetet e përmendura në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje janë përgjegjëse për dërgimin dhe marrjen e kërkesave për ndihmë.

Neni 12
Procedurat e kalimit të kufirit për shpëtimin dhe për ofrimin e ndihmës

Me rastin e shpëtimit dhe të ofrimit të ndihmës, dhe të eliminimit të pasojave të një katastrofe, Palët Kontraktuese u lejojnë ekipeve të shpëtimit dhe ekspertëve individualë që ofrojnë ndihmë, një procedurë të thjeshtuar të kalimit të kufirit.

Në rastin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, ekipet e shpëtimit dhe ekspertët individualë, që marrin pjesë në shpëtimin dhe sigurimin e ndihmës, mund të kalojnë ose në pikat zyrtare të kalimit, ose në pika të ndryshme jozyrtare, bazuar në listën e paraqitur më parë të anëtarëve të ekipit të shpëtimit dhe ekspertëve individualë, me pëlqimin e autoriteteve kompetente.

Anëtarët e ekipit të shpëtimit dhe ekspertët individualë, që ofrojnë ndihmë, mund të qëndrojnë në zonën e Palës Kontraktuese Kërkuese pa vizë ose leje qëndrimi gjatë dhënies së ndihmës. Drejtuesit e ekipeve të shpëtimit duhet të paraqesin një dokument që vërteton autoritetin dhe detyrën e tyre në sigurimin e ndihmës, si dhe një listë të anëtarëve të ekipit të tyre të shpëtimit, ku të dyja do të jenë në gjuhën e Palës Kontraktuese Ndihmëse.

Anëtarët e ekipit të shpëtimit dhe ekspertët individualë që ofrojnë ndihmë kanë të drejtë të mbajnë uniformën e tyre në zonën e Palës tjetër Kontraktuese.

Transporti i armëve, municioneve dhe pajisjeve shpërthyese në zonën e një Pale tjetër Kontraktuese, nuk lejohet.

Në rast katastrofe, shtetasit e Palëve Kontraktuese, si dhe ata të vendeve të treta mund të kalojnë kufijtë ose në pikat zyrtare të kalimit ose në pika të ndryshme jozyrtare, me detyrimin që të raportojnë qëndrimin e tyre në njësinë policore përgjegjëse.

Palët Kontraktuese veprojnë në përputhje me dispozitat e përmendura në paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të këtij neni edhe në rastin kur njëra prej tyre është Palë Kontraktuese Tranzit. Autoritetet përgjegjëse të Palëve Kontraktuese, sa më shpejt të jetë e mundur, informojnë njëri-tjetrin për nevojat e tranzitit, përcaktojnë procedurën për zbatimin e tij dhe, sipas nevojës, sigurojnë ekipin e shpëtimit që ofron ndihmë me shoqërim zyrtar gjatë tranzitit.

Neni 13
Procedurat për hyrje-daljet dhe transportimin e materialeve përtej kufijve me rastin e shpëtimit dhe ofrimit të ndihmës

Palët Kontraktuese thjeshtojnë procedurat për sjelljen, nxjerrjen dhe transportimin përtej kufijve të pajisjeve të shpëtimit dhe llojeve të tjera të pajisjeve të nevojshme për sigurimin e ndihmës ndërkombëtare, si dhe mjeteve që janë të nevojshme për nevojat e tyre, domethënë vetësigurimi i skuadrës së shpëtimit. Me rastin e kalimit të kufirit, udhëheqësi i ekipit të shpëtimit dorëzon listat e inventarit të pajisjeve të shpëtimit, d.m.th. ndihma humanitare për autoritetet doganore përgjegjëse të Palës Kontraktuese Kërkuese.

Listat e inventarit të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni janë në gjuhën zyrtare të Palës Kontraktuese Ndihmëse dhe/ose në gjuhën angleze.

Ekipet e shpëtimit dhe ekspertë individualë, që marrin pjesë në sigurimin e ndihmës, mund të mbajnë përtej kufirit vetëm pajisjet e mbrojtjes dhe të shpëtimit, mjetet e nevojshme për furnizimin dhe për funksionimin e tyre dhe ndihmën humanitare.

Ndalimet ose kufizimet e zbatueshme për transportin ndërkombëtar të mallrave nuk do të zbatohen për transportin e pajisjeve të mbrojtjes dhe të shpëtimit, dhe të ndihmës humanitare ndërkombëtare. Mbrojtja, shpëtimi dhe pajisjet e tjera që nuk janë përdorur gjatë operacioneve të ndihmës, i kthehen Palës Kontraktuese Ndihmëse. Në rast se pajisjet e shpëtimit lihen të papërdorura si ndihmë ndërkombëtare humanitare, lloji, sasia dhe vendndodhja e pajisjeve raportohen tek autoriteti përgjegjësi Palës Kontraktuese Kërkuese, e cila, pasi të pranojë ndihmën, do të informojë autoritetet doganore përgjegjëse në lidhje me to. Në këtë rast zbatohet legjislacioni i Palës Kontraktuese Kërkuese.

Dispozita e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni zbatohet, gjithashtu, për sjelljen e barnave që përmbajnë narkotikë dhe substancave psikotrope për Palën Kontraktuese Kërkuese dhe kthimin e sasive të papërdorura Palës Kontraktuese Ndihmëse. Sjellja dhe nxjerrja e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope nuk trajtohet si import dhe eksport i mallrave në kontekstin e traktateve ndërkombëtare për barna narkotike. Barnat që përmbajnë narkotikë dhe substanca psikotrope mund të sillen vetëm në sasitë e kërkuara për kujdesin urgjent mjekësor dhe mund të përdoren vetëm nën mbikëqyrjen e personelit mjekësor me trajnimin e duhur në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese Kërkuese. Pala Kontraktuese Kërkuese informon Palën Kontraktuese Ndihmëse për barnat e përdorura që përmbajnë narkotikë dhe substanca psikotrope.

Palët Kontraktuese lejojnë përdorimin e pajisjeve të nevojshme të mbrojtjes dhe të shpëtimit dhe ndihmën humanitare të Palës Kontraktuese Ndihmëse pa asnjë procedurë zyrtare, paradhënie ose tarifa të tjera.

Neni 14
Përdorimi i avionëve dhe anijeve për transportimin e ekipeve të shpëtimit dhe ndihma

Avionët dhe anijet mund të përdoren për transport urgjent të ekipeve të shpëtimit ose ekspertëve individualë, që marrin pjesë në sigurimin e ndihmës dhe për lloje të tjera të ndihmës në përputhje me këtë Marrëveshje.

Pala Kontraktuese Ndihmëse njofton menjëherë autoritetin përgjegjës të Palës Kontraktuese Kërkuese për përdorimin e avionëve dhe anijeve për shpëtimin dhe sigurimin e ndihmës dhe i siguron asaj informacion të saktë mbi llojin dhe përcaktimin e avionit ose të anijes dhe të ekuipazhit. Koha, rruga e synuar dhe vendi i uljes ose i vendosjes përcaktohet nga Pala Kontraktuese Kërkuese.

Dispozitat e nenit 12 të kësaj Marrëveshjeje për kalimin e kufijve zbatohen në përputhje me rrethanat për ekuipazhet e avionëve dhe anijeve, si dhe ekipet e shpëtimit dhe ekspertët individualë, që marrin pjesë në sigurimin e ndihmës, ndërsa dispozitat e nenit 13 të kësaj Marrëveshjeje zbatohen për avionët dhe anijet pajisje mbrojtëse dhe shpëtimi të transportuara dhe burime ndërkombëtare të ndihmës humanitare.

Përdorimi i avionëve për shpëtim dhe dhënie të ndihmës për Palën Kontraktuese Kërkuese, bëhet në përputhje me rregulloret e trafikut ajror të asaj Pale Kontraktuese.

Pala Kontraktuese Ndihmëse është e detyruar të paraqesë një plan fluturimi tek ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror që vepron për Palën Kontraktuese

Kërkuese. Përveç elementeve të detyrueshëm të kërkuar, plani i fluturimit i paraqitur për të përdorur avionët duhet të përmbajë një referencë të kësaj Marrëveshjeje.

Përdorimi i automjeteve tokësore, ajrore dhe detare, në mënyrë që të mund të transportojnë ekipet e shpëtimit, me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, lejohet vetëm me pëlqimin e autoritetit përgjegjës të Palës Kontraktuese Kërkuese.

Neni 15
Përgjegjësia për udhëheqjen e shpëtimit dhe sigurimin e operacioneve të ndihmës

Autoritetet e Palës Kontraktuese Kërkuese janë, në të gjitha rastet, përgjegjëse për udhëheqjen e shpëtimit dhe sigurimin e operacioneve të ndihmës.

Një përfaqësuesi të autoritetit përgjegjës të Palës Kontraktuese Kërkuese i besohen detyra vetëm për të shpëtuar drejtuesit e ekipeve nga Pala Kontraktuese Ndihmëse, të cilët informojnë anëtarët e ekipit të shpëtimit në lidhje me të dhënat.

Neni 16
Mbrojtja dhe mbështetja për ekipet e shpëtimit dhe puna individuale e ekspertëve

Autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese Kërkuese sigurojnë mbrojtje dhe ndihmë të përshtatshme për ekipet e shpëtimit dhe ekspertët individualë nga Pala Kontraktuese Ndihmëse, që marrin pjesë në sigurimin e ndihmës.

Neni 17
Mënyra e financimit të kostove të ndihmës

Pala Kontraktuese Ndihmëse nuk ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e kostove të ndihmës së dhënë nga Pala Kontraktuese Kërkuese ose e kostove të pësuara si rezultat i përdorimit, dëmtimit apo humbjes së pajisjeve të shpëtimit.

Pala Kontraktuese Kërkuese përballon shpenzimet e ndihmës, të dhëna me kërkesë të saj nga persona fizikë ose persona juridikë të angazhuar nga Pala Kontraktuese Ndihmëse.

Mjetet motorike të përdorura në operacionet e ndihmës përjashtohen nga tarifat e udhëtimit dhe tarifa të tjera.

Nëse ekipet e shpëtimit dhe ekspertët individualë, që marrin pjesë në sigurimin e ndihmës kanë mbaruar furnizimet e tyre, kostot e prokurimit, akomodimit dhe materialit që i nevojitet deri në përfundimin e dhënies së ndihmës, mbulohen nga Pala Kontraktuese Kërkuese. Nëse është e nevojshme, do të sigurohet mbështetja e duhur logjistike dhe kujdesi urgjent mjekësor.

Neni 18
Kompensimi i dëmeve

Palët Kontraktuese nuk paraqesin asnjë kërkesë për dëmshpërblimin e dëmit material në pajisjet e mbrojtjes dhe të shpëtimit, nëse dëmi është shkaktuar nga ekipi i shpëtimit ose nga ndonjë ekspert individual që ndihmon në ekzekutimin e operacioneve të shpëtimit dhe të ndihmës, sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur është shkaktuar qëllimisht ose për shkak të neglizhencës së rëndë.

Palët Kontraktuese nuk paraqesin asnjë kërkesë për dëmshpërblimin e dëmit material ose jomaterial, në rast të lëndimit trupor, pasojave të përhershme shëndetësore ose vdekjes së një anëtari të ekipit të shpëtimit apo të një eksperti individual, nëse këto ngjarje ndodhin gjatë shpëtimit nën këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur janë shkaktuar me dashje ose për shkak të neglizhencës së rëndë.

Nëse dëmtimi i shkaktohet një personi të tretë gjatë zbatimit të detyrave sipas kësaj Marrëveshjeje, Pala Kontraktuese Kërkuese merr përsipër përgjegjësinë sikur dëmi të ishte shkaktuar nga ekipet e saj të shpëtimit ose nga ekspertët individualë, që marrin pjesë në sigurimin e ndihmës, përveç rasteve kur është shkaktuar me dashje ose për shkak të neglizhencës së rëndë nga ekipet e shpëtimit apo ekspertëve individualë të Palës Kontraktuese Ndihmëse.

Përgjegjësia për dëmin, e parashikuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, lind pas mbërritjes në zonën e Palës Kontraktuese Kërkuese dhe do të vazhdojë deri në largimin nga zona e saj.

Dispozitat e këtij neni zbatohen, gjithashtu, nëse një nga palët kontraktuese është një palë kontraktuese tranzit.

Neni 19
Sigurimi i kujdesit dhe i ndihmës për personat e evakuuar

Personat që, për shkak të një katastrofe, janë evakuuar nga zona e një Pale Kontraktuese në një zonë të një Pale tjetër Kontraktuese, marrin deri në mundësinë e parë për kthimin e tyre, të gjitha furnizimet dhe ndihmën e nevojshme. Shpenzimet e ndihmës dhe të kthimit të këtyre personave përballohen nga Pala Kontraktuese nga ku janë evakuuar, përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe nga Palët Kontraktuese.

Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë kthimin për të gjithë personat që, për shkak të evakuimit, banojnë në një nga Palët Kontraktuese.

Neni 20
Përdorimi i mjeteve të komunikimit

Autoritetet përgjegjëse të Palëve Kontraktuese sigurojnë lidhje reciproke telefonike, radio dhe të lidhje tjera ndërmjet autoriteteve, ekipeve të shpëtimit dhe ekspertëve individualë që marrin pjesë në sigurimin e ndihmës, në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 21
Përdorimi i informacionit

Informacioni i mbledhur si rezultat i aktiviteteve të përfunduara mund t'i vihet në dispozicion një pale të tretë vetëm me pëlqimin me shkrim të Palëve Kontraktuese.

Neni 22
Përfundimi i sigurimit të ndihmës

Sigurimi i ndihmës mund të ndërpritet nëse Pala Kontraktuese Kërkuese tërheq kërkesën për ofrimin e ndihmës ose kur qëllimi i kërkimit të ndihmës është arritur.

Neni 23
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Një mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje zgjidhet përmes negociatave. Nëse nuk arrihet ndonjë marrëveshje në mënyrën e mësipërme, mosmarrëveshja zgjidhet përmes kanaleve diplomatike.

Neni 24
Marrëdhënia e Marrëveshjes me traktatet e tjera ndërkombëtare

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese, që rrjedhin nga traktatet e tjera ndërkombëtare.

Neni 25
Dispozitat përfundimtare

Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit apo miratimit, në përputhje me procedurat e brendshme të secilës Palë Kontraktuese. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut vepron si Depozitues i kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e 30-të (tridhjetë) pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit nga të paktën dy Palë Kontraktuese dhe paraqet efekt juridik vetëm ndërmjet këtyre Palëve Kontraktuese.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të të gjitha Palëve Kontraktuese.

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi në kohë të pacaktuar.

Çdo Palë Kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje, duke njoftuar Depozituesin në mënyrë të shkruar qëllimin e tij për t'u tërhequr nga kjo Marrëveshje. Në këtë rast, Marrëveshja do të ndërpritet nga të qenët në fuqi për atë Palë Kontraktuese 30 ditë nga marrja e njoftimit nga ana e Depozituesit.

Origjinali i kësaj Marrëveshje në një kopje të vetme në gjuhën angleze do të depozitohet tek Depozituesi, i cili do të përcjellë një kopje të certifikuar tek secila Palë Kontraktuese.

Hartuar në Shkup, në ditën e njëzet e nëntë të muajit korrik, në vitin e dymijë e njëzet e një.

Aleksandar Vučić
PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SERBISË

Edi Rama
KRYEMINISTËR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Zoran Zaev
PRESIDENT I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

UDHËZIM
Nr. 21, datë 26.10.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 3743, DATË 10.7.2017, "MBI MODELET DHE STANDARDET E BILETAVE TË TRANSPORTIT RRUGOR TË UDHËTARËVE", TË NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 21/2, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar; të pikës 4, të kreut I dhe pikës 3 të kreut III, të vendimit nr. 85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 3743, datë 10.7.2017, "Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtareve", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:

1. Pika 2 ndryshon si më poshtë:

"Fusha e zbatimit të këtij udhëzimi është përcaktimi i modeleve dhe i standardeve të biletave (me çmim të parashtypur, letër dhe elektronike), si dhe përdorimi i tyre në transportin rrugor të udhëtarëve (qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, ndërkombëtar)".

2. Në pikën 3, shkronja "c", hiqet termi "ndërqytetës" dhe shtohen përkufizimet me përmbajtje, si më poshtë:

"dh) "Biletë në format letër" është biletë për një udhëtim në shërbimin e transportit ndërqytetës të udhëtarëve me autobus, e gjeneruar nëpërmjet sistemit elektronik *e-Transport,* me vulë elektronike, e cila shërben si dokument tatimor në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.".

"gj) "Sistemi elektronik *e-Transport"* është sistem i dedikuar për prerjen e biletave në transportin ndërqytetës, i cili garanton ciklin e plotë fiskal të biletës dhe kryen monitorimin e subjekteve të transportit ndërqytetës nëpërmjet pajisjeve të transaksionit elektronik të biletimit.".

"11) "Agjencia e transportit të udhëtarëve (brenda vendit dhe/ose ndërkombëtar)", është person fizik ose juridik, e licencuar sipas legjislacionit në fuqi, e cila përdor sistemin elektronik *e-Transport* për ndjekjen e ciklit të plotë të pajisjes me bileta (emetimit/shitjes së biletave), përzgjedhjen e linjës së transportit ndërqytetës, caktimin e vendeve/ulëseve në mjet/autobus, të orareve, të fiskalizimit, menaxhimin elektronik në kohë reale të biletave të prera dhe kryen shitjen e biletave për llogari të shoqërisë së transportit, në bazë të kontratës së lidhur midis palëve (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), subjekteve transportuese të pajisura me licencë për shërbimin në linjat e transportit ndërqytetës dhe/ose agjencive të transportit të udhëtarëve).".

"nj) "Pajisje e transaksionit elektronik të biletimit", janë pajisje të instaluara në mjetet e transportit rrugor ose kudo tjetër, të integruara me sistemin *e-Transport*, të cilat plotësojnë kërkesat e ligjit nr. 87/2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", të ndryshuar dhe garantojnë ciklin e plotë fiskal të biletës.".

"sh) "Pagesë *online*" është pagesa e kryer kundrejt operatorëve të transportit për blerjen e biletës së udhëtimit në format letër, nëpërmjet sistemit elektronik *e-Transport* dhe platformës qeveritare të ndërveprimit për pagesën elektronike, zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).".

3. Paragrafi i parë i pikës 4 ndryshon si më poshtë:

"Bileta tatimore me çmim të parashtypur për një udhëtim në transportin qytetës, rrethqytetës dhe transportin ndërkombëtar rrugor përmban në krye të saj të shënuar: Republika e Shqipërisë; ministria përgjegjëse për financat dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në mes shënohet lloji i biletës (qytetës/rrethqytetës dhe/ose transport ndërkombëtar rrugor). Më poshtë shënohet çmimi i udhëtimit. Në fund, në cepin e djathtë, shënohet "Kodi i prodhimit" dhe "nr. serial". Në krahun e majtë vertikalisht shënohen për efekt kontrolli përkatësisht "nr. serial" dhe "Kodi i prodhimit".

4. Shtohet pika 4.1, me përmbajtje, si më poshtë:

"4.1 Bileta në format letër, e gjeneruar nëpërmjet sistemit elektronik *e-Transport* për një udhëtim në transportin rrugor ndërqytetës, përmban në krye të saj të shënuar: Ministria përgjegjëse për transportin rrugor, ministria përgjegjëse për financat, autoriteti kompetent i

licencimit. Në mes shënohet linja, gjatësia e udhëtimit, data e nisjes, ora e nisjes, vendi, etiketa e bagazhit. Në fund shënohet operatori, targa e mjetit, nr. telefoni, NUIS, vendi i nisjes, vendi i mbërritjes, numri i serisë, çmimi. Bileta në format letër përmban elementet e fiskalizimit dhe vulën elektronike. Formati i biletës letër në transportin ndërqytetës është sipas modelit të miratuar me këtë udhëzim. Çmimet e biletave të transportit ndërqytetës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Sistemi elektronik *e-Transport* krijon kushtet e nevojshme për shitjen e biletave për personat që përfitojnë lehtësira në çmim me ligje të veçanta.

Biletat në format letër gjenerohen nëpërmjet sistemit elektronik *e-Transport*, nga agjencitë e transportit të udhëtarëve, pajisjeve të transaksionit elektronik, *online* në *web* ose aplikacioneve mobile nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit për pagesën elektronike, zhvilluar nga AKSHI. Sistemi elektronik *e-Transport* plotëson kërkesat e ligjit nr. 87/2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", të ndryshuar, krijon ndërlidhje në kohë reale me sistemet e treta që mundësohen nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit dhe në të gjitha rastet duhet të sigurojë ciklin e plotë fiskal të biletës. Pajisja e transaksionit elektronik të biletës, e instaluar në mjetet e transportit ndërqytetës ose kudo tjetër, e pajisur me GPS, për efekt monitorimi, jepet në përdorim nga DPSHTRR-ja, sipas kushteve dhe tarifave të përcaktuara në marrëveshjen e lidhur midis palëve, (DPSHTRR, subjekteve/operatorëve transportuese të pajisur me licencë për shërbimin në linjat e transportit ndërqytetës, dhe/ose agjencive të transportit të udhëtarëve)".

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij udhëzimi.

6. Pika 4 e këtij udhëzimi, i shtrin efektet në përputhje me vendimin nr. 224, datë 13.4.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 143
Datë: 2022/10/31 14:43:25
56f5157c-08e1-4367-8725-4fc9a6087949

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë